oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. KLAME SHPK

K21518003F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

*Vlera 851.000 leke pa Tvsh (teteqind e pesedhjetë e nje mije)
(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2. “ERALD” SHPK

LJ74517205P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

*Vlera 926.000 leke pa Tvsh (nenteqind e njezet e gjashte mije)
(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

3. Eduart Xhixha person fizik

L54424205B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

*Vlera 919.800 leke pa Tvsh (nenteqind e nentembedhjetemije e teteqind)
(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

4. MARSİ SHPK

J68028214P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

*Vlera 1.172.100leke pa Tvsh (nje milione e njeqind e shtatedhjetë e dy mije e njeqind)
(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

5.SHAGA SHPK

J96822229J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

*Vlera 1.099.200 leke pa Tvsh (nje milione e nentedhjetenente mije e dyqind)
(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

6. GRAND GRUP SHPK

L67811201P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

*Vlera 1.051.250 leke pa Tvsh (nje milione e pesedhjetë e nje mije e dyqind pesedhjetë)
(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

7. BUNA SHPK J61826501C

Emri i plotë i shoqërisë Numri i NIPT-t

*Vlera 0 leke pa Tvsh (zero)
(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. BUNA SHPK

J61826501C*Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-t*Vlera 0 leke pa Tvsh (zero)*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

per arsye e mëposhtme:

A.Nuk ka përmbushur asnjë nga kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat standarte te tenderit.

2. GRAND GRUP SHPKL67811201P*Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-t*Vlera 1.051.250 leke pa Tvsh (nje milione e pesedhjetë e nje mije e dyqind pesedhjetë)*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

per arsye e mëposhtme:

A.Nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat standarte te tenderit, pasi mungon: Formulari permbledhes i vetedeklarimit nuk eshte paraqitur sipas shtojces 8,

B.Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.3 Kapaciteti Teknik pika 2.3.1 pasi Kriteri i puneve te ngjashme nuk plotesohet pasi zerat e punimeve nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [KLAME SHPK]Adresa: Tirane Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 851.000 (teteqind e pesedhjetë e nje mije) leke pa Tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.Ne rast te mosparaqitjes per te nenshkruar kontraten do te zbatohen parashikimet e nenit 83 te Ligjit 162/2020 Per Prokurimin Publik(i ndryshuar).

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”(i ndryshuar)

BASHKIA LEZHË

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "DRINI A" Shpk, me adrese Lagjia “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe - Shkoder km I-re, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur/ Mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-97293-03-04-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale per mirembajtjen e rrugeve, trotuareve, shesheve, sistemit ujites dhe kullues ne Bashkine Lezhe, per vitin 2024.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes-Kuader.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik "DRINI A" SH.P.K me Nuis J67902505V, me oferte ekonomike 22,364,835 (njezet e dy milion e treqind e gjashtedhjetë e katër mijë e teteqind e tridhjetë e pesë) Lek pa TVSH,
- 2- Operatori Ekonomik "GJOK SMAKAJ" P/F me Nuis K37811508Q, me oferte ekonomike 26,898,984 (njezet e gjashtë milion e teteqind e nentëdhjetë e tetë mijë e nenteqind e tetëdhjetë e katër) Lek pa TVSH,
- 3- Operatori Ekonomik "ORNIAD" SH.P.K me Nuis J68423509H, me oferte ekonomike 27,304,976 (njezet e shtatë milion e treqind e katër mijë e nenteqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH,

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori Ekonomik "GJOK SMAKAJ" P/F me Nuis K37811508Q,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.5, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë raport analize për mallrat sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi i Mallit
1	Çimento 32.5 R
2	Tub Betoni Ø 1000
3	Pllaka trotuari
4	Asfalto beton i ftohte

KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin raport analizen për mallrat e kerkuar në pikën 2.3.5 të DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë raport analize duke mospërmbushur këto kriter.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.7, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga*

organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- ISO 9001:2015, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- ISO 45001:2018, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurise në punë”, ose ekuivalentin e saj.

KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatet ISO sipas kërkesë së pikës 2.3.7 të DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë certifikatë ISO duke mos përmbushur këto kriter.

Sa më sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nënën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nënën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “GJOK SMAKAJ” P/F, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE Operatori Ekonomik “GJOK SMAKAJ” P/F me Nuis K37811508Q, *skualifikohet*.

III. Operatori Ekonomik “ORNIAD” SH.P.K me Nuis J68423509H,

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE nuk plotëson asnjë dokumentacion të kërkuar në DST.

Sa më sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nënën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të

kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ORNIAD” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ORNIAD” SH.P.K, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "DRINI A" Shpk, me adrese Lagjia “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe - Shkoder km I-re, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 22,364,835 (njetzet e dy milion e treqind e gjashtedhjetë e kater mije e teteqind e tridhjetë e pese) Lek pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

HEC LANABREGAS SH.A

Drejtuar: BOE “Ligus” shpk & “AZ Trading” shpk
Nipt L51523001S & NIPT L81515016F

Adresa: “Kashar, Rruga Teodor Keko, Pallati 2 Art Kontruksion, Ap. 13” & “Nj. Adm Nr.7, Blv. Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati I”

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur, prokurim publik me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF – 97575-03-06-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Zëvendësimi i paneleve të kontrollit, sinkronizimit, mbrojtjeve dhe pajisjeve matëse të agregatëve AG.1, AG.2 me sistemin digjital SCADA”. Fondi limit: 36,745,000 (tridhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e dyzetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 5 (pese) muajve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “NOVAMAT” shpk

NUIS K81615002O

Vlera e ofertës = 34,838,496 (tridhjetë e katërmilionë e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. BOE “LIGUS” shpk & “AZ TRADING” SHPK”

NUIS L51523001S & L81515016F

Vlera e ofertës = 35,616,225 (tridhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” shpk

NUIS L52317046G

Vlera e ofertës = 36,263,375 (tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tremijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik “NOVAMAT” shpk

NUIS K81615002O

Operatori ekonomik “NOVAMAT” shpk (ne vijim OE) me NIPT K81615002O skualifikohet per arsyet e meposhtme:

Referuar Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, të pasqyruara në Dokumentat Standarte të Tenderit, sqarojme se:

- a) Oferta ekonomike e paraqitur nga OE ofertues NOVAMAT shpk konsiderohet e pasaktë pasi në Shtojcën 1- Formularin e Ofertës dhe Shtojcën 2 – Lista e cmimeve të artikujve nuk i ka paraqitur sipas formateve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të llojit të procedurës “E hapur – Pune”, sipas të cilave janë hartuar dokumentat e tenderit të publikuar në APP. Specifikisht në Shtojcën 1, pika c) ka cituar: “Ne ofrojmë të furnizojmë Autoritetit Kontraktor HEC Lanabregas sh.a ne perputhje me Dokumentat e Tenderit, mallrat per 45232200-4- Punime ndihmese per linja te energjise elektrike ne perputhje me Oferten Teknike, me cmimet e renditura ne Listen e Artikujve dhe ne perputhje me Termat dhe Kushtet e Kontrates, te cilat reflektohen ne Dokumentat e Tenderit”,

nderkohe ne DST citohet “Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit”. Persa i perket pikës d) ka pasaktesi, pasi ne Shtojcen e plotësuar nga OE nuk janë pasqyruar te 10 pikat te renditura sipas DST por vetem 7 prej tyre. KVO gjykon se në rastin konkret jemi ne kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese. Për këtë shkak shtojca 1 e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për t’u plotësuar. Në rast se, operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor të parashikuar nga neni 75 i LPP-së.

Gjithashtu OE nuk ka plotësuar Shtojcën 2 sipas preventivit të dhënë nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht OE ka perlllogaritur fond rezerve mbi te gjithë artikujt e preventivit dhe jo vetem për “Kabllot e Kontrollit/komandimit/ushqimit” sic përcaktohet në preventivin e publikuar në APP, rrjedhimisht kjo përlllogaritje sjell një gabim ekonomik në ofertë dhe e bën ofertën të pavlefshme. Në LPP Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”. Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

- b)** Formulari Permbledhës i Vetëdeklarimit (Shtojca 8) i paraqitur nga NOVAMAT shpk nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar në DST e procedurës.

Ne pjesën II – Shkaqet e Perjashtimit pika A: DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, OE citon “Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj”, ku ka deklaruar vetem administratorin e kompanisë, nderkohe sipas Shenimit te vendosur ne DST e procedures dhe te publikuara duhet te deklaronte te gjithë personat qe kane vendimmarrje qofte edhe teknike, si Drejtuesi Teknik.

Ne Pjesën III - Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, pika A “Për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut të realizimit të objektit të kontratës” teksti i deklaruar nuk është sipas formatit në DST specifikisht nder te tjera thuhet: “... dhe marrim persiper te realizojme objektin ne perputhje me Listen e Mallrave dhe grafikun e Levrimet te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor” nderkohe qe sipas dokumentave te tenderit do te ishte “... dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor”.

Ne pjesen III Pika B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” nuk është deklaruar numrin i punonjësve sipas Kriterit 2.3.3 si dhe teksti i deklaruar nuk është sipas formatit në DST.

Gjithashtu për piken C ne lidhje me deklarimin e makinerive dhe mjeteve të nevojshme për realizimin e punimeve, OE ka pranuar vetëm disponimin e tyre (përveç deklarimit të informacionit të plote për mjetin Daimler Chrysler dhe të dhenat e tij) por pa specifikuar me të dhëna konkrete për pjesen tjetër të mjeteve si me poshtë sipas Kriterit 2.3.8, siç kërkohen në Formularin e Vetëdeklarimit:

- Megaohmeter 1000 volt,
- Multimeter dixhital 1000VDC 750VAC CAT IV,
- Aparat testimi për relete të mbrojtjes dhe kontrollit me rryme maksimale në dalje 3x75A,
- Darrë ampermetrike 1500A,
- Indikator i sensit të fazave

Për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur një deklaratë për disponueshmërinë e mjeteve por në këtë deklaratë nuk vërteton pronësinë e tyre me anë të dokumentave të njohura ligjërisht (*fatura blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj*).

- c) OE nuk vërteton se plotëson piken 2.3.4: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i releve për instalimin dhe konfigurimin e tyre, si dhe 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i sistemit SCADA për instalimin dhe konfigurimin e SCADA-s, pasi për të dy inxhinierët elektrik të paraqitur nuk ka deklaruar në formularin e përgjithshëm të deklarimit se janë të certifikuar nga prodhuesi ose certifikim ekuivalent dhe gjithashtu në dokumentat e paraqitura për këta inxhinierë nuk rezulton asnjë certifikim, i cili vërteton plotësimin e kësaj pike të kriterëve të vecanta për kualifikim.
- d) OE nuk plotëson piken 2.3.5. Për listën e mëposhtme të komponentëve përbërës të secilit panel, si dhe për kabllot e kontroll-komandimit: OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe as katalog për komponentët:
- Moduli i hyrjeve dixhitale,
 - Moduli i daljeve dixhitale,
 - Moduli i hyrje-daljeve analoge,
 - Moduli i procesimit të të dhënave,
 - Monitoruesi i rrjetit,
 - Ekran 15" HMI,
 - Lëshues manual i motorave,
 - Testblloqe,
 - Automatë katër polarë AC 380 V, 2A (Me kontakte ndihmëse),
 - Automatë dy polarë 220 V DC, 10/16/20/25/A (Me kontakte ndihmëse).
- e) Nga kontrolli i dokumentacionit të hedhur në SPE, rezultoi se dokumentacioni i emërtuar “Paneli AC.pdf” nuk hapet dhe në të pasyrohet shënimi: (Error) (Failed to load PDF document).

2. Operatori Ekonomik “MUHOPLUS LTD” shpk

NUIS L52317046G

Referuar Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, të pasqyruara në Dokumentat Standarte të Tenderit, sqarojmë se:

- a) Formulari Përmbljedhës i Vetëdeklarimit (Shtojca 8) i paraqitur nga MUHOPLUS shpk nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar në DST e procedurës.

Në pjesen III B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” është deklaruar vetëm një inxhinier elektrik, ndërkohe që në kriterin

2.3.4 është specifikuar që nevojiten dy inxhinierë elektrike të certifikuar sipas prodhuesit perkates.

Në pjesën III pika C në lidhje me deklarimin e makinerive dhe mjeteve të nevojshme për realizimin e punimeve, OE ka pranuar vetëm disponimin e tyre por pa specifikuar me të dhëna konkrete secilin mjet që është kërkuar sipas kriterit 2.3.8.

Për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur një deklaratë për disponueshmerinë e mjeteve por në këtë deklaratë nuk vërteton pronësinë e tyre me anë të dokumentave të njohura ligjërisht (*facture blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj*).

- b) OE nuk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Publike asnjë dokument që vërteton Kriterin 2.2.1 mbi kopje të deklaratave të xhiros vjetore dhe bilanceve të kërkuar sipas viteve perkatese, si dhe Kriterin 2.2.2 mbi Vërtetimin për shlyerjen e tarifave dhe taksave nga Pushteti Vendor për Vitin 2023.
- c) OE nuk përmbush Kriterin 2.3.2, sipas së ciles duhet të percaktonte me anë të një Deklarate drejtuesin teknik të punimeve i cili do të ishte i panagazhuar në asnjë kontratë tjetër, gjatë kohezgjatjes së punimeve. Nuk rezultojnë në dokumentat e dorëzuar asnjë deklaratë e tillë.
- d) OE nuk vërteton se plotëson pikën 2.3.4: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i releve për instalimin dhe konfigurimin e tyre, si dhe 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i sistemit SCADA për instalimin dhe konfigurimin e SCADA-s, pasi për të dy inxhinierët elektrik të paraqitur nuk ka deklaruar në formularin e përgjithshëm të deklarimit se janë të certifikuar nga prodhuesi ose certifikim ekuivalent dhe gjithashtu në dokumentat e paraqitura për këta inxhinierë nuk rezultojnë asnjë certifikim, i cili vërteton plotësimin e kësaj pike të kriterëve të vecanta për kualifikim.
- e) OE nuk ka përmbushur Kriterin 2.3.5 pasi nuk ka dorëzuar asnjë dokument të perkthyer dhe të noterizuar mbi pajisjet e kërkuara në këto kriter.
- f) OE nuk ka përmbushur Kriterin 2.3.8 pasi nuk ka dorëzuar asnjë dokument që vërteton pronësinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të percaktuara për kryerjen e punimeve, me anë të dokumentave të njohura ligjërisht (*facture blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj*).

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertat e Operatorëve Ekonomik të mësipërm, për mospërmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “LIGUS” shpk & “AZ TRADING” SHPK me NUIS L51523001S & L81515016F dhe adresë “Kashar, Rruga Teodor Keko, Pallati 2Art Kontruksion, Ap. 13” & “Nj. Adm Nr.7, Blv. Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 35,616,225 (tridhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e mijë e dyqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

SH.A ALBPETROL

Nga: “Albpetrol” sha – Patos

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë,

“START CO” shpk me NUIS L11614001S me adresë: Tiranë, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla G&P, Kati 1,

“NDREGJONI” shpk me NUIS K31329048I, me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr. 32, Hyrja 8,

“VIBTIS” shpk me NUIS L02103503S me adresë: Tiranë, Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla nr 2 , Kati 8/4.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-91395-12-18-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Zëvendësim i pjesshëm i tubacionit magjstral ø 6" nga qendra nr. 17 Drenovë deri në dekantim Usojë”

Kohëzgjatja e kontratës është 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 103 datë 26 Dhjetor 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “SENKA” shpk me NUIS J94808405Q nuk ka paraqitur ofertë ekonomike për këtë tender.
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “START CO” shpk me NUIS L11614001S, “NDREGJONI” shpk me NUIS K31329048I dhe “VIBTIS” shpk me NUIS L02103503S, me vlerë oferte në total 199,983,000 lekë (pa TVSH).

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori Ekonomik “SENKA” shpk me NUIS J94808405Q për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk ka paraqitur asnjë dokument.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë, “START CO” shpk me NUIS L11614001S me adresë: Tiranë, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla G&P, Kati 1, “NDREGJONI” shpk me NUIS K31329048I, me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga “Sule Bega”, Ndërtesa Nr. 32, Hyrja 8 dhe “VIBTIS” shpk me NUIS L02103503S me

adresë: Tiranë, Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla nr 2, Kati 8/4, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 199,983,000 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

* * *

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar).

MINISTRIA E MBROJTJES

Drejtuar : Operatorit ekonomik "KTHELLA" sh.p.k., me NUIS J69303023D dhe adresë : Rrëshen, Kompleksi Kthella Resort, Rruga "Shen Vicenzo De Paolo", përballë varrezave të qytetit.

* * *

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur", prokurim publik me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës: REF-96967-02-29-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Ndërtimi i infrastrukturës së garnizonit stërvitor, Pajet - Bizë, Tiranë", me fond limit 178,672,481 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 9 (nëntë) muajve.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Nuk ka pasur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike me vlerë më e favorshme bazuar në kosto ☐
oferta ekonomike me vlerë më e favorshme bazuar në çmim X.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k., me NUIS J61812013R, me ofertë ekonomike me vlerë 158,847,694 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., me NUIS K11507003S dhe “SENKA” sh.p.k., me NUIS J94808405Q, me ofertë ekonomike me vlerë 132,207,170 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e dyqind e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J dhe “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., me NUIS L04803001U, me ofertë ekonomike me vlerë 148,017,428 (njëqind e dyzet e tetë milionë e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K61625001I, me ofertë ekonomike me vlerë 162,480,647 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, me ofertë ekonomike me vlerë 119,649,324 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH.
6. Operatori ekonomik “KTHELLA” sh.p.k., me NUIS J69303023D, me ofertë ekonomike me vlerë 133,444,033 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e katërqind e dyzet e katër mijë e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” sh.p.k., me NUIS K01730502W dhe “A.K.M” sh.p.k., me NUIS L22301501A, me ofertë ekonomike me vlerë 139,205,056 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
8. Operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K66613407H, me ofertë ekonomike me vlerë 134,263,408 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetë) lekë pa TVSH.
9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTIMI” sh.p.k., me NUIS K11325002C dhe “L.T.E CONSTRUCTION” sh.p.k., me NUIS L78006801F, me ofertë ekonomike me vlerë 154,013,574 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e trembëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.
10. Operatori ekonomik “NIKA” sh.p.k., me NUIS J76705047U, me ofertë ekonomike me vlerë 148,429,440 (njëqind e dyzet e tetë milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e dyzet) lekë pa TVSH.
11. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “PE-VLA-KU” sh.p.k., me NUIS K61716013M dhe “BIBA-X” sh.p.k., me NUIS K32618815N, me ofertë ekonomike me vlerë 166,330,391 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e tridhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
12. Operatori ekonomik “RROKU GUEST” sh.p.k., me NUIS K87921701H, me ofertë ekonomike me vlerë 145,974,375 (njëqind e dyzet e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., me NUIS K11507003S dhe “SENKA” sh.p.k., me NUIS J94808405Q, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon :

Operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., ka këto mangësi :

- Referuar kontratës së bashkëpunimit datë 15.03.2024, lidhur midis O.E. “DAJTI PARK 2007” sh.p.k. dhe O.E. “SENKA” sh.p.k., palët bien dakord për ndarjen dhe kryerjen e punimeve për zbatimin e kontratës si më poshtë :

- “DAJTI PARK 2007” sh.p.k. 50 % e totalit të punimeve;
- “SENKA” sh.p.k. 50 % e totalit të punimeve;

si dhe kanë caktuar si përfaqësues të bashkimit të operatorëve ekonomikë shoqërinë “DAJTI PARK 2007” sh.p.k.

Përmbushja e kërkesave për kualifikim nga anëtarët e BOE duhet të bëhet referuar parashikimeve të pikës 3, të nenit 88, të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, cituar :

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim : ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga kjo shoqëri dhe referuar preventivit të punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë 50 %, të punimeve mekanike, ku përfshihen 50 % të zërave të punimeve të rubrika me emërtesë : Furnizimi me uje dhe shkarkimet, Ndertimi i puseve, linjat e tubave per to dhe kaptazhin e burimit siperfaqesor dhe Sistemimi i ujrave atmosferike, për të cilat ofertuesi nuk ka deklaruar asnjë punonjës të specializuar/kualifikuar si (Teknik Hidroteknik) i cili është kërkuar në funksion të realizimit të punimeve mekanike objekt kontrate.

Bazuar në sa më sipër dhe referuar volumeve të punimeve mekanike (KUB dhe KUSH 50 % të tyre), që shoqëria “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., ka marrë përsipër të kryejë, KVO gjykon se ofertuesi duhet të kishte 1 (një) punonjës të specializuar/kualifikuar si (Teknik Hidroteknik).

Bazuar në nenin 88, pika 3 të Rr.P.P., miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se :

...

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje;

Në përfundim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vlerëson se operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/b, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT.

Gjithashtu nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga kjo shoqëri dhe referuar preventivit të punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë 50 % të punimeve Rrugë dhe Sheshe. Konkretisht këtu përfshihen 50 % të zërave të punimeve si : Shtresë binderi me granil gur kave, 8cm, me makineri (rruga), Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri (rruga) dhe Shtresë stabilizanti t=20cm (rrugë + sheshe +bazamenti b/a), për të cilat ofertuesi nuk ka deklaruar se ka të punësuar në stafin e shoqërisë asnjë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., si (Buldozerist) nga 2 (dy) punonjës që janë kërkuar në funksion të realizimit të punimeve të rubrikës Rrugë dhe Sheshe.

Bazuar në sa më sipër dhe referuar volumeve të punimeve Rrugë dhe Sheshe 50 % të tyre, që shoqëria “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., ka marrë përsipër të kryejë, KVO gjykon se ofertuesi duhet të kishte minimumi 1 (një) punonjës të kualifikuar të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., si (Buldozerist).

Bazuar në nenin 88, pika 3 të Rr.P.P., miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se :

...

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vlerëson se operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” sh.p.k., ka këto mangësi :

- Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/f, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi ofertuesi referuar ndarjes së punimeve, rezulton se do të kryejë 50 % të punimeve Rrugë dhe Sheshe, për të cilat nuk ka deklaruar asnjë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., si (Buldozerist), të cilët janë kërkuar në funksion të realizimit të punimeve të sipërcituara dhe në funksion të mjeteve të kërkuara sipas pikës 2.3.4, të DT dhe të deklaruara nga ofertuesi si (Asfaltoshtuese, Grejder dhe Rrul ngjeshës) manovratorëve të këtyre mjeteve u jepet dëshmi për BULDOZERIST, bazuar kjo në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Ndërsa anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve “SENKA” sh.p.k., ka këto mangësi :

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga kjo shoqëri dhe referuar preventivit të punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “SENKA” sh.p.k., rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë 50 % të punimeve të (Hekurit, Betonit, Armaturës, Konstruksioneve metalike, Hidroizolimeve dhe Suvatimeve), për të cilat ofertuesi nuk ka deklaruar asnjë punonjës të specializuar/kualifikuar si (Hekurkthyes, Betonues dhe të tjerë që lidhen me to, Karpentier, Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm, Hidroizolues dhe Suvatues), të cilët janë kërkuar në funksion të realizimit të këtyre punimeve objekt kontrate.

Bazuar në sa më sipër dhe referuar volumeve të punimeve të ndërtimit 50 % të tyre, që shoqëria “SENKA” sh.p.k., ka marrë përsipër të kryejë, KVO gjykon se ofertuesi nuk disponon dhe nuk ka personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e zërave të punimeve që shoqëria “SENKA” sh.p.k., ka marrë përsipër të realizojë.

Bazuar në nenin 88, pika 3 të Rr.P.P., miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se :

...

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje;

Në përfundim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vlerëson se operatori ekonomik “SENKA” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/b, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT. Gjithashtu nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga kjo shoqëri dhe referuar preventivit të punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “SENKA” sh.p.k., rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë 50 % të punimeve Rrugë dhe Sheshe dhe 50 % të punimeve të ndërtimit të puseve, për të cilat ofertuesi nuk ka deklaruar se disponon mjetet e nevojshme si (Autobitumatriçe dhe Autosondë) mjete këto të cilat janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punimeve të sipërcituara.

Bazuar në sa më sipër dhe referuar volumeve të punimeve Rrugë dhe Sheshe, ndërtimi i puseve 50 % të tyre, që shoqëria “SENKA” sh.p.k., ka marrë përsipër të kryejë, KVO gjykon se ofertuesi nuk disponon mjetet e nevojshme si (Autobitumatriçe dhe Autosondë) për realizimin e zërave të punimeve që shoqëria “SENKA” sh.p.k., ka marrë përsipër të realizojë.

Bazuar në nenin 88, pika 3 të Rr.P.P., miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se :

...

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vlerëson se operatori ekonomik “SENKA” sh.p.k., ka këto mangësi :

- Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi ofertuesi referuar ndarjes së punimeve, rezulton se nuk disponon mjetet e nevojshme si (Autobitumatriçe dhe Autosondë) për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “DESARET COMPANY” sh.p.k., me NUIS K01816001J dhe “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., me NUIS L04803001U, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon :

Operatori ekonomik “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., ka këto mangësi :

- Referuar kontratës së bashkëpunimit datë 15.03.2024, lidhur midis palëve (DESARET COMPANY sh.p.k., dhe Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company d.sh.h.), palët bien dakort për ndarjen dhe kryerjen e punimeve për zbatimin e kontratës si më poshtë :

- “DESARET COMPANY” sh.p.k. 36.51 % e totalit të punimeve;
- “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h. 63.49 % e totalit të punimeve;

si dhe kanë caktuar si përfaqësues të bashkimit të operatorëve ekonomikë shoqërinë “DESARET COMPANY” sh.p.k.

Përmbushja e kërkesave për kualifikim nga anëtarët e BOE duhet të bëhet referuar parashikimeve të pikës 3, të nenit 88, të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, cituar:

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Konkretisht lidhur me kërkesën për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.2/a, të Kapacitetit Teknik, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, operatorët ekonomikë anëtarë të BOE duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- N.P - 1 A Punime gjurmimi në tokë;
- N.P - 2 B Ndërtime civile e industriale;
- N.P - 4 C Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale;
- N.P - 7 A Ujshjellësa, gazshjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje;
- N.P - 11 B Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;
- N.S - 18 A Punime topogjeodezike;
- N.S - 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

O.E. “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., ka paraqitur licencën NZ.7055/11, nga ku rezulton se ofertuesi nuk disponon kategorinë përkatëse për punimet speciale të ndërtimit.

Konkretisht ofertuesi për zbatimin e punimeve objekt kontrate nuk disponon kategorinë N.S - 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Referuar parashikimeve të shkronjës “a”, pika 1, Kreu III të VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

Referuar preventivit të punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë të gjitha punimet e ndërtimit të puseve dhe realizimin e proceseve të shpimit (sipas parashikimeve të VKM nr. 42, datë 16.1.2008), KVO konstaton se kjo shoqëri nuk disponon kategorinë N.S - 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë, kategori kjo e cila është kërkuar në funksion të ndërtimit të puseve.

Bazuar në sa më sipër, KVO gjykon se O.E. “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., me licencën NZ.7055/11, të paraqitur në SPE nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.2/a, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, lidhur me licencën profesionale të shoqërisë për zbatimin e punimeve që ka marrë përsipër të kryejë ofertuesi.

Gjithashtu Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga kjo shoqëri dhe referuar preventivit të punimeve që do të kryhen nga operatori ekonomik “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër të kryejë të gjitha punimet për ndërtimin e puseve dhe realizimin e proceseve të shpimit, për të cilat nuk ka deklaruar se disponon personelin kryesor të kualifikuar dhe të nevojshëm për realizimin e punimeve për ndërtimin e puseve, sipas ndarjes së tyre, referuar preventivit të punimeve objekt kontrate. Konkretisht, nuk ka deklaruar si drejtues teknik në licencën e shoqërisë Inxhinierin Gjeolog/Hidrogjeolog/Gjeoteknik.

Bazuar në nenin 88, pika 3 të Rr.P.P., miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se :

...

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje;

Në përfundim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vlerëson se operatori ekonomik “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” d.sh.h., nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/a, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi ofertuesi referuar ndarjes së punimeve, rezulton se do të kryejë të gjitha punimet për ndërtimin e puseve dhe realizimin e proceseve të shpimit, për të cilat nuk ka deklaruar se disponon si drejtues teknik në licencën e shoqërisë Inxhinierin Gjeolog/Hidrogjeolog/Gjeoteknik, i cili është kërkuar në funksion të realizimit të këtyre punimeve.

3. Operatori ekonomik “INA” sh.p.k., me NUIS J61814009W, nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.8, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi certifikatat ISO 9001:2015,

45001 - 2018 dhe 14001:2015, të paraqitura në SPE nga ofertuesi rezultojnë të pavlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe kanë skaduar që më datë 08/03/2024.

4. Operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K66613407H, me dokumentacionin e paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon :

- Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k., me NUIS K66613407H, ka gabime aritmetike dhe shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë në një vlerë më të lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Konkretisht në ofertën e paraqitur nga ofertuesi nuk është përfshirë vlera totale e rubrikës C/1 PUNIME ELEKTRIKE me vlerë 26,279,818 (njëzet e gjashtë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Bazuar në sa më sipër, vlera e ofertës duhet të ishte 161,857,216 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH dhe jo 134,263,408 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e tetë) lekë pa TVSH, për rrjedhojë diferenca e gabimeve aritmetike në vlerë është 27,593,808 lekë pa TVSH, vlerë kjo më e lartë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. Bazuar në pikën 3, të nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të refuzojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k.

Këtë qëndrim ka mbajtur dhe K.P.P me vendimin nr. 989/2022.

5. Operatori ekonomik “NIKA” sh.p.k., me NUIS J76705047U, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon :

